

## NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.771/2018

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm-Gjyqtari i vetëm gjykues** Gëzim Ademi, në çështjen penale kundër të pandehurës R.M. nga fsh. ... Komuna ..., ku edhe jeton për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 8 lidhur me par 6 dhe 1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.nr.1332/2018 të datës 18.09.2018, në mungesë të prokurores Danjella Batkoviq, në prezencën të të pandehurës me datën 26.02.2019, ka shpallur publikisht, ndërsa me 28.02.2019 ka përpiluar këtë:

### A K T G J Y K I M

**E pandehura: R.M., nga e ëma ... e vajzërisë ..., e lindur më ... fsh. ... - ..., Serb me shtetësi të Serbisë, punon në furrë të bukës, e martuar, nënë e tre fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike.**

### Ë S H T Ë F A J T O R

**SEPSE:** Me dt.16.01.2016 rreth orës 09:15 minuta, në rrugën ... në ..., para furrës "...", duke mos i u përmbajtur dispozitës së nenit 92 par.5 Ligji mbi sigurinë e komunikacionit rrugor, ka rrezikuar komunikacionin publik, duke menduar lehtësisht që deri tek fatkeqësia nuk do të vij, ose që do të mund ta evitoj, në atë mënyrë që ka drejtuar PMV kombi, e tipit 'Mercedes Vito', me ngjyre të bardhe, pa tabelë të regjistrimit, dhe pastaj gjatë ndaljes së automobilit nuk ka ndërmarrur të gjitha masat e nevojshme - nuk e ka ngritur frenin e dorës, dhe makina është nisur prapa - në rikverc ku e ka goditur pastaj të dëmtuarën D.R., duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore në formë të thyerjes së eshtrave të pasme të legenit pa lëvizje të fragmenteve dhe ndrydhjeve të ideve të buta të legenit, lëndimet i ka marrur e pandehura.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 në lidhje me par.6 e 1 të KPRK-se**

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 4,7,8,9,10,23,50,51,52,73, dhe 378 par.8 në lidhje me par.6 e 1 të KPRK-ës dhe nenit 365, 450,463, të KPP-ës e:

### G J Y K O N

**ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 6 (muajve), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen vepër penale në kohëzgjatjeje prej 1 (një) viti.**

**Obligohet** e pandehura që t'i paguaj shpenzimet procedurale dhe atë, për ekspertizën mjekoligjor shumen prej 20€, për ekspertizën e komunikacionit shumen prej 40.88€ ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, shumen prej 30 euro, dhe në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 euro, të gjitha këto është i obliguar që t'i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest te rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

### **I. Aktakuza**

**Prokuroria Themelore ne Mitrovicë** ka ngritur aktakuze PP.nr.1332/2018 te datës 18.09.2018, kundër te pandehurës R.M., për shkak te veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 8 lidhur me par 6 e 1 të KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.26.02.2019, ashtu qe ne këtë seance e pandehura lidhur me fajësinë ka deklaruar: e ndjej veten fajtores pe veprën penale qe me vihet ne barre, me vjen keq për rastin qe ka ndodhur, e aq ma shume se te dëmtuarën e kam familjare (kumat), pra burrat vëllezër i kemi, i premtoj gjykatës se ne te ardhmen do te jem i kujdesshëm dhe nuk do te kryej vepra penale.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurorja deklaroi se konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë dhe i ka propozuar gjykatës qe te pranohet fajësia e te pandehurit ngase pranimi i fajësisë është i mbështetur ne provat te cilat mbështetësin rrethanat faktike te çështjes se aktakuzës.

### **II. Vlerësimi i pranimin te fajësisë.**

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurës ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimin te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga e pandehura, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: raportin policor me nr.2016-ST-005, te datës 16.01.2016, deklaratat e te dëmtuarës, deklarata te te pandehurës, ekspertiza mjekoligjore, si dhe ekspertiza e komunikacionit e datës 24.08.2018, si dhe foto dokumentacioni qe gjendet ne shkresa te lendes. të gjitha këto për gjykatën për veç se vërtetojnë faktet e çështjes së akuzës njëkohësisht janë me përputhjen e pranimin të fajësisë nga e pandehura, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurës.

### **III. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.**

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e dënueshme me dënim me burgim prej 6 muajsh deri ne 5 vite, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale, ne rastin konkret i pandehuri kishte rrezikuar jetën e personit.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerëses dhe sjelljet e saj pas kryerjes se veprës penale, e njëjta është mbajtëse e familjes, po ashtu fakti se e pandehura ishte ne lidhje familjare me te dëmtuarën, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese

pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i saj me rastin e pranimit te fajësisë rezulton se e njëjta e ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i te pandehurës për gjykatën shpreh një pendim te thelle te saj për veprën penale, si rrethane tjetër lehtësuese ka gjetur se ne te dhënat e shkresave se lendes nuk rezulton se kjo e pandehur te jete dënuar ndonjë here për ndonjë vepër penale apo te jete zhvilluar ndonjë procedurë penale, prandaj gjykata vlerëson se bazuar ne këto rrethana kjo e pandehur kishte rene ndesh me ligjin vetëm me rastin konkret ku e ka pranuar fajësinë.

Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurës pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit me kusht. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson e edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurës.

#### **IV. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.**

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur që te pandehurën ta detyroj qe shpenzimeve procedurale për ekspertizën e komunikacionit ti paguaj shumen prej 40.88€, (katër dhjet euro e tedhjet e tët cent), për ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 20 € (njëzet euro), ndërsa ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimin shumen prej 30 euro, dhe ne emër te paushallit gjyqësorë te paguaj shumën prej 20€(njëzet euro) te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

#### **V. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.**

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te demtuarit i ka udhezuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar ne neni 248, 365, 450, e 463 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË Departamenti i Përgjithshëm P. nr.771/2018 dt.28.02.2019**

Procesmbajtësja :  
**Hasnije Muhaxheri**

Gjyqtari i vetëm gjykues  
**Gëzim Ademi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate.